

VENDIM
Nr. 370, datë 22.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I TREGUT TË GJËSË SË GJALLË”, BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë”, Bashkia Korçë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh, të përballohet nga Bashkia Korçë.
 5. Shpenzimet procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia Korçë.
 6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, pranë Bashkisë Korçë.
 8. Bashkia Korçë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuar.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Korçë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I TREGUT TË GJËSË SË GJALLË”

Nr.	PRONARI		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)							VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Sip. që shpronësohet				
								Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	XHEVAIR	CAUSHLLARI	8564	132/17	arë	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	VASILIKA	KOSTA	8564	132/16	arë	6,000	6,000	100	600,000	600,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	AFROVITI	KOSTA	8564	132/15	arë	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	HENA	VASILI	8564	132/14	arë	9,000	9,000	100	900,000	900,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA										2,100,000	